

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA

P.nr.26/17

VENDIMI ËSHTË I PLOTËFUQISHËM
 DËLLIKA JE PRAVNOSNAŽNA
 GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
 FERIZAJ I UROŠEVAC NË EMËR TË POPULLIT

16. 11. 2017

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEPARTAMENTI I PERGJITHSHEM,

si gjykatë e shkallës së parë penale, me gjyqtarin e vetëm gjykues Sahit Krasniqi, dhe me sek juridike Adelina Sallahu, në çështjen penale kundër të akuzuarve: [REDAKTUAR] për shkak të veprës penale në vazhdim vjedhje nga neni 325 par.1 lidhur me nenin 85 të KPK-së, dhe [REDAKTUAR] për shkak të veprës penale në vazhdim blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par.1 lidhur me nenin 85 të KPRK-së, sipas aktakuzave të Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr. 2389-3/16 të dt. 12.01.2017, PP/II.nr. 2419-7/16 të dt. 05.01.2017 dhe PP/II.nr.2352-1/16 të dt. 23.01.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me dt. 18.04.2017, në praninë e përfaqësuesit të aktakuzës prokurorit të shtetit [REDAKTUAR] të akuzuarve [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], të njejtën ditë mori dhe publikisht komunikoi këtë:

AKTGJYKIM

Të pandehurit:

[REDAKTUAR], I lindur me dt. [REDAKTUAR] në [REDAKTUAR], nga I ati [REDAKTUAR] dhe e ëma [REDAKTUAR], me vendbanim të përhershëm në rr. " [REDAKTUAR] " pn. Në [REDAKTUAR] shqiptar, shtetas I R. Kosovës, I pa punë, ka të kryerr shkollën e mesme, I pa martuar, I gjendjes së dobët ekonomike, me numer personal [REDAKTUAR] mbrohet në liri.

[REDAKTUAR] I lindur me dt. [REDAKTUAR] në [REDAKTUAR], nga I ati [REDAKTUAR] dhe e ëma [REDAKTUAR], e vajzërisë [REDAKTUAR], me vendbanim të përhershëm në [REDAKTUAR] rr. " [REDAKTUAR] " nr. [REDAKTUAR], shqiptar, shtetas I R. Kosovës, I martuar, babe I një fëmije, teknik I federates së çiklizmit, ka të kryer shkollën e mesme, I gjendjes së dobët ekonomike me numer personal [REDAKTUAR], mbrohet në liri.

JANË FAJTOR

I pandehuri [REDACTED]

I.

Sepse : me datën 04.03.2016, gjatë orëve të mbrëmjes me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete, në korridorin para hyrjes së banesave të [REDACTED] në rrugën “ Skënder Salihaj” në Shtime ka marrë biçikletën ngjyrë të zezë, me pika të gjelbërta prone e të dëmtuarit [REDACTED] të cilën pastaj i aka shitur të pandehurit të dytë. Me ç rastë të dëmtuarit I ka shkaktuar dëm material në vlerë rreth 100 euro

II.

Sepse: me dt. 10 maj 2016, rreth ores 20:20, në rrugën “ Hajriz Muhadini” në Ferizaj me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm pasurorë për vete apo për personin tjetër, ka kryer vjedhje në dëm të dëmtuarit [REDACTED] në të mënyrë që shfrytëzon kohën e fjalës së namazit dhe shkon në oborrin e xhamisë nga ku merr një biçikletë të markës “ Crossroads” me ngjyrë të kaltër dhe me këtë I shkaktonte dëm material të dëmtuarit në vlerë prej 70 euro.\

III.

Sepse: me dt. 07.05.2016, rrethë ores 13:00 në rrugën “Vllëzrit Gërvalla” në Ferizaj, I pandehuri me qëllim që me përvetësimin e sendeve të luajtshme, vetit ti sjell përfitim pasuri në mënyrë të kundërligjshëm, ka marrë pasurin e tani të dëmtuarit [REDACTED] në atë mënyrë që derisa I dëmtuari e kishte lënë biçikletën e tij të tipit “Capriola”, ngjyrë e kaltërt dhe e zezë, në oborrin e xhamisë dhe ishte hyrë për ta falur dreken, I pandehuri ka shfrytëzuar raastin dhe të njejtën e ka marrë ku pastaj të njejtën biçikletë i aka shitur tani të pandehurit [REDACTED] me çmim prej 55 euro, ku të dëmtuarit I ka shkaktuar dëm.

- Me këtë ka kryer veprën penale në vazhdim vjedhje nga neni 325 par.1 lidhur me nenin 85 të KPRK-së.

I pandehuri [REDAKTUAR]

I.

Sepse: me dt. 05.03.2016, në mëngjesë, në servisën e tij për rregullimin e biçikletave në rrugën “Varoshi” në Ferizaj, ka ablerë nga I pandehuri [REDAKTUAR] për çmim prej 20 euro biçikletën ngjyrë të zezë me pika të gjelbërta për të cilën e dinte se është përfituar me kryerjen e veprës penale.

II.

Sepse: me datë 10.05.2016, në lokalin NTP [REDAKTUAR] që gjendet në rrugën “Rexhep Bislimi” në Ferizaj, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për vetë, ka ablerë nga I pandehuri [REDAKTUAR] një biçikletë të markës “Crossroads” me ngjyrë të kaltër për çmimin prej 20 euro edhe pse e ka ditur se biçikleta ka qenë e përfituar me kryerjen e veprës penale.

III.

Sepse: me dt. 07.05.2016, rreth orës 13:00, në rrugën “Rexhep Bislimi”, në lokalin e tij NTP [REDAKTUAR] në Ferizaj, I pandehuri [REDAKTUAR] nga I pandehuri [REDAKTUAR] ka ablerë biçikletën e tipit “Capriola”, ngjyrë e kaltërt dhe e zezë, me çmim prej 55 euro edhe pse e ka ditur se e njëjta ishte përfituar me kryerjen e veprës penale të vjedhjes, e për të cilën në ndërkohë është vërtetuar se është prone e të dëmtuarit [REDAKTUAR] ku pas identifikimit nga policia është sekuestruar dhe I është kthyer të dëmtuarit.

- Me çka ka kryer veprën penale në vazhdim blerja, pranimi ose fsheja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par.1 lidhur me nenin 85 të KPRK-së

Në bazë të dispozitiës së sipërcituar dhe neneve 4, 7, 17, 21, 41, 42, 46, 49, 50, 51, 52, dhe nenit 73 të KPRK-së si dhe nen. 365 të KPPK-së, i,

G J Y K O N

Të pandehurit [REDAKTUAR] I caktohet dënim burgimi në kohëzgjatje prej 6/gjashtë/muaj, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 600/gjashtëqind/ euro, i cili nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën kohor prej 1/një/viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryenë vepër tjetër penale.

Të pandehurit [REDAKTUAR] I caktohet dënim burgimi në kohëzgjatje prej 6/gjashtë/muaj, i cili nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën kohor prej 1/një/viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryenë vepër tjetër penale.

Obligohen I pandehurit që në emër të paushallit gjyqësor secili veç e veç të paguaj shumen prej 20 (njëzetë) € në afat prej 30 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzat PP/II.nr. 2389-3/16 të dt. 12.01.2017, PP/II.nr. 2419-7/16 të dt. 05.01.2017 dhe PP/II.nr.2352-1/16 të dt. 23.01.2017 i ka ngarkuar të të akuzuarit [REDAKTUAR] me tri vepra penale vjedhje nga neni 325 par.1 të KPRK-së, [REDAKTUAR] me tri vepra penale bleja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me anë të vepres penale nga neni 345 par.1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 18.04.2017, në të cilën përfaqësuesi i akuzës prokurori i shtetit [REDAKTUAR] në fillim të shqyrtimit fillestar propozoi që conform nenit 35 të KPP-së, gjykata të bëjë bashkimin e procedurës penale për të pandehurit dhe bëri ricilsimin e veprave penale sa I përket të pandehurit

██████████ ashtu që për tri veprat penale të vjedhjes të kryera me dt. 04.03.2016, 07.05.2016 dhe 10.05.2016 ngarkohet me një veper penale në vazhdim vjedhje nga neni 325 par.1 lidhur me nenin 85 të KPRK-së, ndërsa sa I përket të akuzuarit ██████████ tri veprat penale të kryera me datat 04.03.2016, 07.05.2016 dhe 10.05.2016 ngarkohet me një vepre penale në vazhdim blerja, përfitimi ose fsheja e sendeve të përfituara me anë të vepreave penale nga neni 345 par.1 lidhur me nenin 85 të KPRK-së, dhe ka mbetur n; t;rsi pran; ricilsimit t; veprave penale duke I propozuar gjykates që të pandehurit të shpallen fajtores dhe të iu shqiptohet një dënim të paraparë me ligj.

Gjykata duke u bazuar në propozimin e prokurorit të shtetit dhe pasi i vlerësoi të gjitha shkresat e lëndëve morri aktvendim që të bëhet bashkimi i procedurave penale për lëndët P.nr.65/17, P.nr.216/17 dhe P.nr.38/17, dhe lënda të evidentohet me numër P.nr. 65/17.

Te akuzuarit ██████████ dhe ██████████ me rastin e deklarimit te pranimit apo mos pranimit te fajësisë kanë deklaruar se e pranojnë fajësinë për veprat penale për të cilat i ngarkon aktakuza, dhe i propozojnë gjykatës që të iu shqiptojë një dënim sa më të butë.

Gjyqtari i vetëm gjykues konstaton se janë plotësuar kriteret nga nen. 248 par.1 të KPPK-së nga se:

- të pandehurit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë,
- pranimi i fajit bëhet vullnetarisht nga të pandehurit,
- pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materiale e prezantuar nga prokurori i shtetit si dhe në provat tjera që gjenden në shkresat e lëndës, siç janë: vërtetimet mbi konfiskimin e sendeve të dt. 18.05.2016 dhe 18.05.2016 dhe vërtetimi mbi kthimin e sendeve të sekuestruara të dt. 19.05.2016 dhe 24.05.2016 si dhe foto dokumentacioni që gjendet në shkresat e lëndës dhe se
- aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ██████████ manifestohen të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale në vazhdim vjedhje nga neni 325 par.1 lidhur me nenin 85 të KPRK-së, dhe në veprimet e të pandehurit

██████████ manifestohen të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me anë të veprës penale nga neni 345 par.1 lidhur me nenin 85 të KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit në kuptim të nenit 73 të KPRK-së, si rrethana **lehtësuese** mori faktin se të pandehurit kanë pranuar fajësinë, ndërsa si rrethana lehtësuese mori parasysh pendimin e thellë për kryerjen e kësaj vepre penale, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejnë vepra të tilla apo të ngjashme penale, ndërsa si rrethanë rënduese morri parasysh faktin se të njëjtit në vazhdim i kanë kryer veprat penale, andaj mbi bazën e rrethanave të tilla gjykata të pandehurit ██████████ për veprën penale në vazhdim vjedhje nga neni 325 par.1 lidhur me nenin 85 të KPRK-së i shqiptoi dënim burgimi në kohëzgjatje prej **6/gjashtë/muaj dhe dënim me gjobë në lartësi prej 600/gjashtëqind/ euro** i cili dënim nuk do të ekzekutohet në çoftë se i pandehuri në periudhën kohore prej **1/një/viti** nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale, dhe të pandehurit ██████████ i shqiptoi dënim i shqiptoi dënim burgimi në kohëzgjatje prej **6/gjashtë/muaj** i cili dënim nuk do të ekzekutohet në çoftë se i pandehuri në periudhën kohore prej **1/një/viti** nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale me bindjen se në rastin konkret edhe përmes shpalljes së dënimit dhe pa ekzekutimin e tij do të arrihet qëllimi i dënimit me kusht dhe qëllimi i përgjithshëm i dënimeve, në kuptim të preventives speciale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejt në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallen e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurve.

Konformë nenit 450 par.2 pika 6 të KPPK-së obligohen të pandehurit që në emër të paushallit gjyqësor secili veç e veç të paguajn shumën prej 20 (njëzet) euro, e cila është caktuar duke pasur parasyshë gjendjen ekonomike të pandehurve dhe komplikushmerinë e kësaj çështje penale.

Nga arsyet e sipërcekura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEPARTAMENTI I PERGJITHSHEM,**P.nr.65/17 e dt. 18.04.2017**

Sekretaja Juridike

Adelina Sallahu

Gjyqtari individual

Sahit Krasniqi



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, lejohet ankesa në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykates së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.

